



Planuar / Ditezuar Prijmljeno / Predloženo Kuvend / Dnevnik	13.01	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	SKPDM/HEK	122/2022	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
				1/3



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1196/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Hxhnikaj-Demi anëtare. Flakron Gashi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar e ankesën e datës s A.nr.1196/2021, të datës 17.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë : në Komunë të Prishtinës, kundër organit të punësimit Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në çështjen juridike "ndërprerje të marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës /në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.01.2022, mori këtë;

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent për të vendosur* për ankesën me numër A.nr.1196/2021 e datës 17.12.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 17.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 6211/21, kundër Vendimit të Qeverisë me numër 09/46 të datës 30.11.2021, me pretendimin ankimor se vendimi është i kundërligjshëm, me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, i cili ka qenë i emëruar në pozitë: "Zëvendës Drejtor për Shërbime Administrative Financiare", në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, sipas Vendimit nr.18/50 të datës 05.06.2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova : Ankesën e datë 17.12.2021 nr. Protokollit 6211/21 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbime Civile të Kosovës; Vendimin Nr.09/46 të datës 30.11.2021; Shkresa E-mail i datës 08.12.2021 lidhur me mbledhjen e 46 të Qeverisë, me vendimet e bashkangjitura; Vendimin Nr.14/46 i datës 30.11.2021; Vendimin Nr.13/46 e datës 30.11.2021; Vendimin Nr.12/46 e datës 30.11.2021; Vendimin Nr.11/46 e datës 30.11.2021; Vendimin Nr.10/46 e datës 30.11.2021; Vendimin Nr.08/46 e datës 30.11.2021; Vendimin Nr.07/46 e datës 30.11.2021; Vendimin Nr.06/46 e datës 30.11.2021; Vendimin

Nr.05/46 e datës 30.11.2021; Vendimin Nr.04/46 e datës 30.11.2021; Vendimin Nr.03/46 e datës 30.11.2021; Vendimin Nr.02/46 e datës 30.11.2021; Vendimin Nr.01/46 e datës 30.11.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoje se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me pozitën e Zëvendës Drejtor për Shërbime Administrative dhe Financiare në Agjencinë e Navigimit Ajror, kishte vendosur me Vendimin A.nr.412/2018 për shkak se në këtë kohë këto pozita binin në kuadër të shërbimit civil të Kosovës.

Mirëpo me hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë në Kosovë Nr.06/L-114 është përcaktuar me nenin 83 paragrafi 1.2.3 deklarimi i statusit të nëpunësve civil në Republikën e Kosovës si dhe në bazë të Rregullores Nr. 10/2020 për Deklarimin e Statusit të Nëpunësve Civil, gjegjësisht nenit 4 të kësaj Rregullore. Departamenti për Menagjimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të MPB-së ka kompetencë që të bëjë deklarimin e statusit të nëpunësve civilë në Republikën e Kosovës.

Këshilli i Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës duke vendosur sipas vendimit A.nr.857/2021 dhe nisur nga dispozitat e lartshënuara, me datë: 19.11.2021 ka kërkuar nga Departamenti për Menagjimin e Zyrtarëve Publikë informata lidhur me statusin e të punësuarve në Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror, DMZP po të njëjtën datë ka informuar KPMSHCK-në se më datë 02.03.2021 ka bërë njoftimin për ASHN se të punësuarit në këtë institucion kanë statusin e Shërbyesve Publik, duke përfshi edhe pozitën e Zëvendës Drejtorit për Shërbime Administrative dhe Financiare në ASHN.

Bazuar në atë që u tha më lartë, Kolegji konstaton se pozita e Zëvendës Drejtorit për Shërbime Administrative dhe Financiare në Agjencinë për Navigacion Ajror nuk është pozitë e shërbyesve civilë, prandaj në pajtim me nenin 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe të kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.Nr.1196/2021

Flakron GASHI

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

